



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.09.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Termovision” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “Termovision” SH.P.K., e dt.26.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 24.09.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:24.09.2025;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Termovision" SH.P.K., me dt.26.09.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ngrohja, klimatizimi – Muzeu Etnografik", Nr. i prokurimit- 632-25-7679-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-101-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.09.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar sepse kërkesa e Autoritetit kontraktues në FDT ka qenë që të prezantohet Vendimi për caktimin e udhëheqësit të punishtes:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 3 (tre) punëtorë të mjaftueshëm, si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier i diplomuar apo master i inxhinjerise mekanike - drejtimi termoeenergjetikë me përvojë pune minimum 3 vite dhe i licencuar (menaxher i projektit) b). Nje inxhinjer i diplomuar apo master i arkitekturës –me përvojë pune pune minimum 5 vite dhe i licencuar c). Nje inxhinjer i diplomuar apo master i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me përvojë pune minimum 5 vite dhe i licencuar ç). Nje nga inxhinjeret të jetë i licencuar me licence A1 nga MKRS për trashëgimi kulturore

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, udhëheqës i punishtës duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për udhëheqës i punishtës si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

Ju nuk e keni prezantuar këtë vendim, për këtë arsye oferta juaj është refuzuar si administrativisht e papërgjegjshme.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

